

VENDIM
Nr. 67, datë 19.12.2019

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME FIER SHA
(ndryshuar m vendimin nr. 120, datë 20.10.2020)

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”(VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 19.12.2019 pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e projekt vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Fier (UK Fier), me shkresat me shkresat nr. 122 prot., datë 31.1.2018, me lëndë “Kërkesë për licencim”, nr. 576, datë 19.9.2019, me lëndë “Mbi plotësim dokumentacioni” nr. 584 prot., datë 23.9.2019, me lëndë “Plotësim dokumentacioni” nr. 663, datë 23.10.2019, me lëndë “Mbi plotësim dokumentacioni” nr. 768, datë 12.12.2019, me lëndë “Plotësim dokumentacioni” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Fier në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Fier ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për 154 667 banorë të Bashkisë Fier;

b) Shoqëria UK Fier mbulon me aktmiratim higjieno-sanitar 85% të popullsisë së shërbyer.

Drejtuesi teknik i shoqërisë, z. Vasil Marko, me diplomë në “Inxhinieri mekanike”, viti 1994.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Fier, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

5. ERRU-ja, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Fier rekomandon:

- Shoqëria UK Fier duhet të punojë në drejtim të pajisjes së sistemeve të furnizimit me ujë me akt miratime higjieno-sanitare për të gjithë zonën e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Fier është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Fier sh.a., me NUIS J63423411D, në kategoritë:
 - a) kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
 - b) kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura.
2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Fier sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara, me:
 - a) drejtues ligjor – Piro Ndreu;
 - b) drejtues teknik – Vasil Marko.
3. *Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Fier sh.a është Bashkia Fier.*
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.
5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Fier sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Fier sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani